

L I G J
Nr.7930, datë 11.5.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7805, DATË 16.3.1994 “PËR TATIMIN MBI
PASURINË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Neni 15 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Tatimi mbi ndërtesat është vjetor dhe paguhet në çdo kohë brenda çdo viti tatimor pavarësisht nëse shfrytëzohet ose jo ndërtesa”.

Neni 2

Në nenin 17 bëhen këto ndryshime:

Paragrafi II,

Ndërtesat për shërbime private shëndetësore, artizanale e komunale bëhen..... 40
lekë/m² në vit.

Po në këtë nen, paragrafi V, pas fjalës “sportive” shtohet ajo “ushtarake”.

Neni 3

Në nenin 20 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

4. Mosparaqitja në afat e të dhënave për banesat private në qytet dhe në fshat nga personat e ngarkuar në organet e pushtetit lokal.

Neni 4

Në fund të nenit 21 shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

- Për shkeljet e pikës 4 me gjobë 3000 deri 5000 lekë.

Neni 5

Pas nenit 23 shtohet neni 23/1 me këtë përmbajtje:

“Organet e pushtetit lokal, komuna e bashki janë të detyruara që brenda 6-mujorit të parë të çdo viti të dërgojnë në degët e tatimeve të çdo rrethi, sipas formularit të përcaktuar nga Ministria e Financave, të dhënat për banesat private në qytet e fshat”.

Neni 6

Ndërmarrjet elektrike në rrethe shërbejnë si agjentë tatimorë dhe përfitojnë 5 për qind mbi arkëtimet e realizuara nga tatimi i ndërtesave.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1100, datë 23.5.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha